



Feim Ibrahim (Gjirokastër 1935 - Torino 1997).

I cilësuar si kompozitori që tronditi tabutë e realizmit socialist, është nga kompozitorët e parë shqiptarë të formuar tërësisht në vend, duke hyrë në Konservatorin Shtetëror të Tiranës në 1962, ku edhe u diplomua në vitin 1966, nën udhëheqjen e Prof. Tish Daija. Menjëherë pas studimeve, punoi si pedagog i kompozicionit, kontrapunktit dhe harmonisë (1966-1973) dhe në vitet 1973-1977 u emërua Zv/Drejtor i ILA. Periudhën më të gjatë të jetës së tij e kaloi si Sekretar për muzikën në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve në vitet 1977-1991 dhe më pas Drejtor i Teatrit të Operës dhe Baletit (1991-1992). Në fund, ishte profesor i kompozicionit në Akademinë e Arteve deri në largimin e tij nga jeta.

Gjatë periudhës së izolimit kulturor të Shqipërisë, F. Ibrahim u tregua një administrator i aftë, duke ushtruar një influencë pozitive në jetën muzikore shqiptare. Edhe pse në kushte jo të favorshme, sepse edhe vetë posti që ai kishte e detyronte të mbronte realizmin socialist, gjatë udhëtimeve të tij jashtë shtetit, Feim Ibrahim kërkonte të ecte me hapin e zhvillimeve muzikore ndërkombëtare, duke eksperimentuar në mënyrë sekrete muzikën atonale (p.sh. *Quasi Sonata per violoncello e piano*, 1975, rev. 1990), duke treguar interes për Xenakis që në vitin 1981 dhe duke ftuar në Shqipëri figura avanguardiste, si G. Stabler. Ai u mundua gjithmonë të sillte të renë në muzikë, duke shkuar kundër rrymës komuniste dhe pas rënies së diktaturës u përpoq me çdo mjet për të çuar muzikën shqiptare në arenën ndërkombëtare, duke u bërë kështu, në vitin 1991, Presidenti i parë i Komitetit Nacional të Muzikës (anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës pranë UNESCO-s) dhe themeluesi i festivalit “Mbrëmje të Muzikës së Re Shqiptare” në vitin 1992.

Në vitin 1994 krijoi shoqatën artistike “Pentaton”, që synonte organizimin e eventeve të ndryshme kulturore, si dhe krijimin e një konservatori privat për muzikantë të rinj me aftësi të veçanta muzikore. Disa nga veprat e tij janë botuar nga Emerson Edition (Angli).

Pas titullit “Artist i Merituar”, për meritat e tij artistike, në vitin 1989 ka marrë edhe titullin “Artist i Popullit”. Për kontributin e dhënë në zhvillimin e kulturës shqiptare, Bashkia e Tiranës në vitin 2000 i ka akorduar titullin “Mirënjohja e Tiranës”. Në vitin 2001 dhe 2008 Bashkitë e Durrësit dhe të Gjirokastrës i kanë dhënë titullin “Qytetar Nderi”.

Ka fituar shumë çmime në konkurset kombëtare dhe në “Koncertet e Majit”. Ka fituar dy çmime të Republikës, çmimi më i lartë për krijimtarinë në Shqipëri.

Në vitin 1990, në Aalto theaterfoyer, në Essen (Gjermani), u organizua dita “Feim Ibrahim – portret artisti”. Në vitin 1994, me ftesë të presidentit të Brahmsgesellschaft, kaloi një periudhë si “composer-in-residence” në shtëpinë e J. Brahmsit në Baden-Baden dhe më pas qendroi në Salzburg, për të studiuar muzikën elektronike në Mozarteum. Në 1995, vepra *De Profundis* që ai kompozoi gjatë studimeve në Mozarteum, u zgjodh për Festivalin e Muzikës Elektroakustike “Synthèse” në Bourges (Francë).

Vepra e F. Ibrahimit, i përfshin të gjitha zhanret, që nga miniaturat instrumentale, muzika e filmit, muzika e dhomës, muzika simfonike, koncertet për instrument solist dhe orkestër e deri tek veprat skenike dhe elektroakustike. Ato ekzekutohen me shumë sukses në Shqipëri, Kosovë, Itali, Francë, Angli, Gjermani, Amerikë, etj.

Dialogo per violoncello e pianoforte dhe Romanza “E la tua veste è bianca” (me vargjet e poetit S. Quasimodo), për soprano, violonçel dhe piano - të dyja të kompozuar në 1997 – janë veprat e fundit të kompozitorit, i cili vdiq papritur në Torino (Itali), në 2 Gusht 1997.

PROGRAMI I KONCERTIT

Suitë nga baleti "Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë" (1986)

Prolog
Dardina dhe Probatini
Vallja e robinave
Finali

Dirigjent: Petrika Afezolli

E la tua veste è bianca – Romancë për soprano, violonçel e piano (1997)

Dosvidanja – Romancë për soprano e piano (1996)

Soprano: Emiljana Palushaj
Violonçel: Igert Zeqiri
Piano: Etrita Ibrahim

Dialogo për violonçel e piano (1997)

Violonçel: Igert Zeqiri
Piano: Etrita Ibrahim

Valle Epike (1974)

Dirigjent: Enea Sadushi

Abel(Es) Meditation për piano solo (1994)

Toccatà për piano solo (1962)

Piano: Etrita Ibrahim

Xhaketa e kuqe – teksti Vllasova Musta (1970)

Rrjedh në këngë e ligjërime – teksti Gjokë Beci (1980)

Këndon: Manjola Nallbani
Dirigjent: Petrika Afezolli

G. Mahler – Sinfonia nr. 3, koha e VI-të

Langsam, Ruhevoll, Empfunden (Lentamente, tranquillo,
profondamente sentito)

"Was mir die Liebe erzählt (Quello che l'amore mi narra)"

Dirigjent: Petrika Afezolli



Universiteti i Arteve
Fakulteti i Muzikës
Tiranë **UA**

Indaute $\text{♩} = 66$

Organizon:

**FEIM
IBRAHIMI**

In Memoriam

e premtë
11 dhjetor 2015

Tryezë e rrumbullakët:

Vendi i Feim Ibrahimit në muzikën shqiptare

Moderator Prof. Dr. Fatmir Hysi

Salla e pedagogëve, ora 11.00

Koncert me rastin e 80-vjetorit të lindjes

Orkestra simfonike e Universitetit të Arteve

Dirigjentë: Petrika Afezolli, Enea Sadushi

**Solistë: Manjola Nallbani, Etrita Ibrahim,
Emiljana Palushaj, Igert Zeqiri.**

Salla e Koncerteve e UART, ora 19.00

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza",
Tiranë, ALBANIA
www.uart.edu.al